



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:249983  
Datë: 29.01.2024  
Numri i dokumentit: 05252501

**C - IV. – 23- 0643**

**Paditësi:**

R C nga Prishtina, e të cilin me autorizim e përfaqëson, av. R C nga Gllogoci.

**Kundër**

**E paditura:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr.“Dritan Hoxha” nr.55, Lagjja, ”Lakrishtë”, Prishtinë.

**Objkti i kontestit :** Kompensimi i pagave të pa paguara.

**Për :** Palët ndërgjyqëse.

**Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me dt.29.01.2024, merr këtë:**

**A K T G J Y K I M**

**I. PRANOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit, R C nga Prishtina e paraqitur kundër të të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë – Autoritetit i Likuidimit (AL) dhe **NDRYSHOHET pjesërisht, Vendimi, PRN126-0161 i dt.31.03.2015** i të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoritetit të Likuidimit (AL), dhe **OBLIGOHET, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditësit, R C nga Prishtina, t’ia kompensoj pagat e të pa paguara për periudhën prej muajt shtator të vitit 2011, pra për 4 (katër) paga mujore në shumën prej 1,676.00 €, për vitin 2012, 12 (dy mbëdhjetë) paga mujore, në shumën prej 5,028.00 €, për vitin 2013, 12 (dy mbëdhjetë) paga mujore, shumën prej 5,028.00 € dhe për vitin 2014, 6 (gjashtë) paga mujore, në shumën prej 2,514.00 € e në shumën e përgjithshme prej **14,246.00 € (katër mbëdhjetë mijë e dy qind e dy zetë e gjashtë)** si dhe shumën prej **1,424,60 (një mijë e shtatë qind e tre mbëdhjetë euro e një zetë centë)** në emër të kamatës ligjore prej 10 %, si kërkesë aksesore nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), “Auto Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe se shuma e pranuar, duhet të përmbushet në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit e nga shuma totale e kërkuar prej 54,470.00 € për pagat e të pa paguara për periudhën duke filluar nga muaji Tetor 2003 e deri në Qershor 2014 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), “Auto Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim).**

**II. REFUZHET pjesërisht si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit, R C nga Prishtina për kompensimin e pagave të pa paguara e duke filluar nga muaji tetor i vitit 2003 e deri në muajin Gusht të vitit 2011 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), “Auto Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe Vendimi, PRN126-0161 i dt.31.03.2015 i të paditurës, Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), **VËRTETOHET pjesërisht, si i drejtë dhe i bazuar në ligj** derisa **REFUZHET pjesërisht pa bazuar** edhe pjesa e kërkesëpadiisë së paditësit, R C nga Prishtina lidhur me kumatën ligjore vjetore prej 3,5 % për çdo vit.

**III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.**

### **Rrethanat Procedurale dhe Faktike :**

Me dt.29.04.2015, paditësi përmes postës, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), ka parashtruar padi kundër Vendimit, PRN126 – 0161 të dt.31.03.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh) “Auto - Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim) e me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij në emër të kompensimit e pagave të pa paguara në shumën prej 54,470.00 € për periudhën prej muajit tetor 2003 deri në qershor 2014 nga NSh “Auto - Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim) e me të cilën ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të aprovohet padia dhe kërkesa e paditësit si e bazuar, të detyrohet, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit që paditësit, t’ia paguaj borxhin kryesor për pagat e pa paguara për periudhën e lartë cekur kohore, si dhe t’ia paguaj kumatën ligjore vjetore prej 3.5 % për çdo vit.

Paditësi në këtë padi/kërkesë, ka theksuar se i punësuar në NSh, “Auto Prishtina”, me dt.11.11.2004, me shkresën nr. protokoli, 15373, ishte njoftuar nga ana e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, se likuidimi i ndërmarrjes së lartëpërmendur, ka filluar me dt.21 Korrik 2014 në bazë të vendimit të Bordit të AKP-së sipas neni 9.1 të Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit e gjithashtu i ishte dërguar edhe shkresa e cituar e cila e njoftonte me Vendimin e Bordit për Likuidim, se anulohen të gjitha kontrata e punës deri atëherë në fuqi në mes Ndërmarrjes Shoqërore dhe të punësuarit, si dhe është informuar se ai do të paraqitet në selinë qendrore të AKP-ës, përkatësisht në Autoritetin e Likuidimit të NSH-së. Tutje ka shtuar se si i punësua në NSH së bashku me të punësuarit nëpërmjet menaxhmentit dhe kryesisë së sindikatës kishte depozituar një Regjistër me nr.4 dt.12.06.2014, i cili përmbante emrin e të punësuarit, pagën mujore, periudhën kohore tetor 2003 - qershor 2014 gjegjësisht 130 muaj, për të cilën nuk ishin paguara pagat e të punësuarve në tërësi për 38 të punësuar siç janë cituar në regjistër dt. 12.06.2014 i cili u pranua nga e paditura, AKP dt.12.09.2014, se paditësi nuk ka pushuar së kërkuari pagesën e pagave mujore sipas kontratës deri në njoftimin se për NSH-në ka filluar procedura e likuidimit, për të cilën ka marrë veprime të ndryshme ligjore për realizimin e të drejtës në pagesën e pagave dhe kontributeve pensionale, se shuma e përgjithshme për të gjithë paditësit, ishte 870,410,00 euro e me propozimin që gjykata të merr aktgjykim e me të cilin, aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit, detyrohet e paditura, Agjencioni Kosovar i Privatizimit që paditësit, t’ia paguaj borxhin kryesor për pagat e mbetura të pa paguara për periudhën tetor 2003 – qershor 2014 në shumën prej 54,470.00 euro, si dhe të detyrohet e paditura që paditësit, t’ia paguaj kumatën ligjore vjetore në vlerë prej 3,5 % për çdo vit e më gjerësisht si në këtë padi.

Paditësi kësaj ankese ia ka bashkangjitur provat kopje: autorizimin për përfaqësim të dhënë nga kryesia e Sindikatës së NSH, “Auto Prishtina” për K B certifikatën për regjistrimin e biznesit të dt.24.05.2000 për SH.A. “Auto Prishtina”, konfirmim biznesi të dt.17.04.2000 për SH.A. “Auto Prishtina”, njoftimin e dt.23.04.2015 së të autorizuarit të paditësit të adresuar në Autoritetin e Likuidimit të Zyrës Rajonale të AKP-së në Prishtinë, shkresën e AKM-së së dt.18.11.2004,

shkresën e AKM-së së dt.19.08.2004 (në dy kopje), lista, Nr.pr.04 e dt.12.06.2014 e Ndërmarrjes Shoqërore (NSh), "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë të punëtorëve aktiv të cilët nuk kanë marru rrogat sipas kontratës së punës të lëshuar nga Kryetari i Këshillit të Punëtorëve të NSh, "Auto Prishtina", kontratën e punës, nr. 325 të dt.13.10.2003 të lidhur në mes paditësit dhe SH.A. "Auto Prishtina", deklarata e paditësit të dhënë për Zyrën Rajonale të AKP-së në Prishtinë dhe kopjen e librezës së punës derisa pjesë e shkresave të lëndës, është edhe Parashtresa e dt.22.1.2021 për dorëzimin e autorizimit të dhënë nga 34 ish punëtorët e NSh-së në lëndët gjegjëse pranë DhPGJSK si dhe autorizimi i dt.08.01.2021 i dhënë nga S Z për av.Sh S nga Prishtina.

Me dt.28 Qershor 2022, DhPGJSK-ja, me Urdhrin e saj, C – 15 – 0682 të dt.28.06.2022, padinë e pasditësit i ka dërguar të paditurës për të paraqitur Përgjigje në padi dhe se njëjta me dt.07.07.2022, e paditura, AKP, ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj ankesës së ushtruar kundër Vendimit, PRN126 – 0161 të dt.31.03.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) e në të cilën, ka theksuar se ankesa e paditësit, nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë së saj nga neni 72.2 i Shtojcës së Ligjit, Nr.04/ L – 033 sepse paditësi nuk ka bashkangjitur Vendimin e ankimuar në ankesë, se mungesa e një autorizimi për përfaqësim nga ana e avokatit përbën shkak të mjaftueshëm, për pa pranueshmërinë sipas neni 28 par.2.1 dhe 2.6 së bashku me nenin 25.5 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/ L – 033, se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-033, është shkelur nga AL-ja e kjo përbën shkelje të nenit 70.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033, se kërkesa e parashtruesit, është parashkruar sepse paditësi, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor kundër NSh-së në periudhën tre vjeçare të parashkrimit e cila fillon të llogaritet më së voni nga shtatori i viti 2003 kur parashtruesi vetë ka pranuar se nuk është paguar nga ana e NSh-së, se parashkrimi bazohet në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.03/L - 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar që sanksionon parashkrimin brenda tre vjetësh, se parashkrimi fillon nga dita e parë që kreditorit i ka lindur e drejta të pretendojë përmbushjen e detyrimit, se pikërisht fakti se kërkesa e paditësit, referon si moment të cenimit të së drejtës shtatorin e viti 2003, çka përbën sipas nenit 360 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr.1978/26 dhe ligj i zbatueshëm në kontestin në fjalë) momentin e nisjes së afatit 3 vjeçar të parashkrimit, se AL-ja, ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike si dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të zbatueshme, se pa paragjykuar qëndrimin e mësipërm se detyrimi NSH-së (nëse ka ekzistuar ndonjëherë), është shuar përmes parashkrimit, e paditura, thekson se gjithashtu se në fakt detyrimi për të paguar paditësin, nuk ka lindur asnjëherë, se kjo NSH, nuk ka kryer aktivitet ekonomik në periudhën kontestuese, andaj parashtruesi nuk ka punuar për NSH-në gjete asaj periudhe, se edhe kontrata e punës që paditësi, e ka dorëzuar në shkresat e lëndës, është në mes tij dhe një ndërmarrje private (jo shoqërore), se si pasojë e kësaj NSH-ja nuk ka legjitimitet pasiv në këtë lëndë pasi marrëdhënia juridike për të cilën parashtruesi ankohet këtu është në mes tij dhe një personi të tretë e duke i propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa si e pa pranueshme dhe e pabazuar dhe të vërtetoj Vendimin i Autoritetit të Likuidimit në bazë të nenit 74.4 të Shtojcës së Ligjit, Nr.06/L-086 dhe se kësaj Mbrojtjeje, ia ka bashkangjitur Vendimin e AL-së, PRN126 – 0161 të dt.31.03.2015 dhe Vendimin për emërimin e anëtarëve në Autoritetin e Likuidimit për NSh, "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë (në likuidim).

Me aktgjykimin e saj, C – IV – 15 – 0682 të dt.06 Korrik 2022, DhPGJSK-ja, ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit e parashtruar kundër të paditurave, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Ndërmarrja Shoqërore (NSh) "Auto - Prishtina" me seli në Prishtinë (në likuidim) lidhur me kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën tetor 2003 – qershor 2014, në shumën prej 54,470.00 € e me normë të kamatës prej 3,5 % në vit e më gjerësisht si në arsyetimin e këtij aktgjykimi dhe se pas ushtrimit të ankesës kundër këtij aktgjykimi, Kolegji i

Apelit i kësaj gjykate se me aktgjykimin, AC – I – 22 – 0428 - A0001 të dt.16 Nëntor 2023, e ka

aprovuar ankesën e paditësit, ka anuluar aktgjykimin e kësaj gjykate, C – IV – 15 – 0682 të dt.06 Korrik 2022 dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe se pas kthimit në ri gjykim, kjo lëndë, e ka marrë numrin, C – IV. – 23 - 0643.

Me dt.27.11.2023, DhPGJSK-ja, me aktvendimin e saj, C – IV – 15 – 0643 të dt.27.11.2023, ka urdhëruar, paditësin, R C nga Prishtina dhe K B nga Hajvalia, që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, të rregullojnë padinë sa i përket çështjes së përfaqësimit të tij në lëndën, C – IV. – 23 - 0643, në atë mënyrë që të deklarohet me shkrim se a do t'a përfaqësoj vetveten si palë në procedurë ose në këtë gjykatë, të dorëzoj autorizimin për përfaqësim, të lëshuar – të dhënë nga vet ai si paditësi, për K B nga Hajvalia për t'a përfaqësuar në lëndën, C – IV. – 23 – 0643 pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) si dhe se K B nga Hajvalia, i autorizuar i paditësit, para gjykatës duhet t'a provojë se është avokat dhe është anëtarë i Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK) e në mënyrë që të ketë të drejtë që të jetë përfaqësues i palës paditëse pranë DhPGJSK-së, dhe e tëra kjo që gjykata të mund të procedoj më tej në këtë çështje juridike e me pasojën gjegjëse që në rast se paditësi si dhe ia autorizuari i tij, nuk i ndërmarrin veprimet procedurale brenda këtij afatit të dhënë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata padinë e paditëses, do t'ia hedhë poshtë mbi baza të papranueshmërisë së saj, në bazë të nenit 32, 36 par.3 dhe nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme ose të njëjtën padi, gjykata do t'ia konsideroj si të tërhequr ose të njëjtën padi (ankesë) do t'ia hedh poshtë si jo të plotë në kuptim të nenit 99 dhe nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) e me pasojat gjegjëse në rast të mos veprimit sipas këtij aktvendimi.

Me dt.06.12.2023, paditësi përmes të të autorizuarit të tij, av. R C nga Gllogovci, i është drejtuar kësaj gjykate, me parashtrësën e dt.04.12.2023 e në të cilën ka theksuar se e ka revokuar autorizimin tjetër për përfaqësim në këtë çështje juridike të dhënë deri më tani e duke ftuar gjykatën që lidhur me këtë çështje të komunikoj me këtë avokatë me adresë si në shkresat e lëndës, dhe se kësaj parashtrëse ia ka bashkangjitur autorizimin e dt.27.11.2023 e përmes të cilit, e ka autorizuar këtë avokat që t'a përfaqësoj në këtë lëndë.

Me dt.19.01.2024, DhPGJSK-ja, me urdhrin e saj, C – IV. – 23 – 0643 të dt.19.01.2024, ka urdhëruar të paditurën, AKP-në që në afatin prej 3 (tre) ditëve pas ditë së pranimit të këtij urdhri, pranë kësaj gjykate, duhet të parashtrëj/dorëzoj, sqarim lidhur me çështjen e rregullsisë së transformimit të NSh,"Auto Prishtina" me seli në Prishtinë në shoqëri aksionare, si dhe të siguroj dokumentin gjegjës zyrtar e nga i cili do të provohej se sa ka qenë pagë mujore që paditësi e ka marr apo e ka pasur tek Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe për mënyrën e pagesës, pasi që kërkesa ka qenë paushallë, se a ka pasur të drejtë që vet paditësi, të e nënshkruaj listën e pagave, në cilësi të kryetarit të Këshillit të Punëtorëve si dhe se a është valid ky dokument për periudhën kohore para vitit 2003 e që lidhet me kërkesën e bërë nga paditësi për pasi që ky dokument është i lëshuar në vitin 2014, dhe është nën llogon e NSh-së ndërsa kontrata e punësimit, paditësi e kishte lidhur me Shoqërinë Akcionare, e po ashtu të jap sqarim se a janë bërë pagesa nga e paditura në formë të akontacionit në shumën prej 85.00 euro për çdo muaj për paditësin gjatë periudhës prej tetorit 2003 e deri në qershor 2014 e më gjerësisht si në këtë urdher.

Me dt.26.01.2024, e paditura, AKP-ja, është përgjigjur në Urdhrin e lartë përmendur të kësaj gjykate e në të cilën ka sqaruar se Ndërmarrja në fjalë, është në likuidim dhe nuk është shoqëri aksionare, se paditësi në procedurën e likuidimit, ka parashtruar disa kërkesa kreditore dhe atë për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës, për tri paga të pa paguara si dhe një kërkesë tjetër për pagat e pa paguara në shumën dhe periudhën e pa përcaktuar dhe se për secilën kërkesë

ka vendimmarrje veç e veç nga AL-ja, se nuk ka mundur të siguroj informacionet psh, se si ka

qenë mënyra e pagesës, se a ka pasur të drejtë që vet paditësi të nënshkruaj listën e pagave si dhe se ka cekur se ajo ka mund që të siguroj listën e pagave të NSh-së për muajin prill të vitit 2003, dh i renditur nën numrin 16 (është cekur nr.15) dhe se kësaj përgjigjje ia ka bashkangjitur kopjen e listë së të ardhurave për muajin prill 2003.

### **Arsyetimi ligjor:**

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej Ligji i Dhomës së Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata marr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, pretendimeve të palëve në procedurë si dhe në bazë të vërejtjeve të bërë nga Kolegji i Apelit të DhPGJSK-së të dhëna në aktvendimin e tij, AC – I – 22 – 0428 - A0001 të dt.16 Nëntor 2023,, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit, R C nga Prishtina, duhet të pranohet pjesërisht si e bazuar për një pjesë të saj derisa duhet të refuzohet si e pabazuar për pjesën tjetër të saj,

### ***Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.***

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), “Auto Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.21 Korrik 2014 dhe se paditësja në procedurën e likuidimit, me dt.11. Shtator 2014, ka paraqitur kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 54,470.00 € për periudhën prej muajit Tetor 2003 deri në Qershor 2014 nga Ndërmarrja Shoqërore (N.SH), “Auto Kosova” me seli në Prishtinë, e cila kërkesë është refuzuar me Vendimin, PRN126-0161 të dt.31.03.2015, të AL dhe se paditësi, pas pranimit të këtij Vendimi pas dt.31.03.2015, ankesën kundër Vendimit të kontestuar të AL-së, PRN126-0100 të dt.31.03.2015, pranë DhPGJSK-së, e ka bërë përmes dërgimit me postë me dt.29.04.2015, pra brenda afatit prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të këtij Vendimi dhe se kësaj ankese, edhe pse nuk ia ka bashkangjitur, ekzemplarin e Vendimit të kontestuar të AL-së, PRN126-0161 të dt.31.03.2015, pjesë e shkresave të lëndës, është ky Vendim i kontestuar i AL-së. Andaj gjykata konstaton se ankesa - padia e ushtruar nga paditësi kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN126-0161 të dt.31.03.2015, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë nga neni në kuptim të nenit 36 lidhur me nenin 33 dhe 35 dhe 74 të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) dhe nenit 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP).

### ***Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.***

Gjykata vlerëson se në mes palëve ndërgjyqëse, nuk është kontestuese se paditësi me të paditurën, Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), “Auto Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim), kanë pasur raport të marrëdhënies së punës siç evidentohet nga kopja e librezës së punës si dhe Njoftimi i të paditurës, AKP-së, Nr.26/52 i dt.06.09.2013 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për paditësin dhe se këto dy prova thelbësore kanë përmbajtje që mund të përputhen me deklaratimet në parashtruesat gjegjëse, pra nga kopja e librezës së punës, evidentohet se parashtruesi tek, NSh-ja, ka themeluar marrëdhënie të punës me Ndërmarrjen Shoqërore (N.Sh), “Auto

Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim) por se si fakt kontestues, është ngritur çështje se

paditësi, a ka të drejtë që t'a kërkoj kompensimin e pagave të pa paguara në shumën dhe periudhën e lartëcekur, si dhe këtë kërkesë a e ka bërë brenda afati ligjor prej 3 (tre) vjetëve apo jo.

Në nenin 6 të Ligjit Nr.-4/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të Agjencisë, aty thuhet se :”*Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2. ....*” .

Gjykata konstaton se në rastin konkret, kemi të bëjmë me kërkesat e pa siguruar nga neni 40 par.1 pika 1.7 i Shtojcë së Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), e që flet për Prioritetin e kërkesave dhe interesave, e në të cilin parashihet se :” *Në procedurat e likuidimit të gjitha Kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim. .. kërkesat e pasiguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë*”.

Për çështjen e pagesës së pagave së të një punësuari në një ndërmarrje në nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/27 i dt.8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës), ka qenë e paraparë se : “*Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës*” kurse në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : “*I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...*” . Për ndërprerjen e një kontrate të punës së një të punësuari nga punëdhënësi i tij, në nenin 11 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2001/27 i dt.8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) e që flet për Shkëputjen e kontratës së punës, aty parashihet se :”*Kontrata e punës shkëputet: ... dhe (dh) sipas fuqisë ligjore*” derisa në nenin 14 par.1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/2007, ka qenë e paraparë se : “*Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës*” kurse nenin 67 të Ligjit të Punës, Nr. 03/ L-212 të dt.1 nëntor 2010, që flet për Ndërprerjen e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore, aty thuhet se :”*Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: ... 1.8. me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes*” ndërsa në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : “*I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...*”

Në bazë të nenit 31 par.1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përcaktohet se: “*Palët, në parashtrësit e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës*” kurse në nenin 36 par.2 pika 1 dhe 2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se “*... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme .... se dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese*” ” derisa në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, parashihet se: “*Pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të*

*punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet*” e për më tepër edhe

në nenin 87 të Ligjit të Punës, Nr.03/L – 012, gjithashtu, parashihet afati i njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par.1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata gjen se pjesërisht nuk qëndron pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit, është e pas afatshme sipas dispozitave të zbatueshme ligjore nga neni 36.2.1 dhe 2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP së dhe nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar lidhur me nenin 372 të LMD (1976) për një pjesë të kërkesëpadisë dhe atë se bazuar në listën e të ardhurave për muajin prill 2003, paditësi, ka qenë i renditur nën nurmin rendor 16 gjegjësisht sipas listës së punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marr rrogat sipas kontratës së punës, është renditur nën numrin rendor, 02 dhe pagën mujore bruto, në vitin 2003, e ka pasur, 515,00 € kurse shumë neto prej 469.00 derisa në vitin 2014, pagën mujore bruto e ka pasur 504,00 € kurse shumë neto e ka pasur në shumë prej 419.00 € dhe se sipas një përlllogaritjeje, pra për vitin 2011, paditësit, i takojnë 4 (katër) paga mujore neto në shumë prej 1,676.00 € (4 x 419 = 1,676.00 €), për vitin 2012, 12 paga mujore, në shumë prej 5,028.00 € (12 x 419 € = 5,028.00 €), për vitin 2013, 12 paga mujore, shumë prej 5,028.00 € (12 x 419 € = 5,028.00 €) dhe për vitin 2014, 6 paga mujore, në shumë prej 2,514.00 € ((6 x 419 € = 2,514.00 €) e në shumë e përgjithshme prej 14,246.00 € (1,676,00 € + 5,028.00 € + 5,028.00 + 2,514.00 € = 14,246.00 €) për periudhën kohore prej muajit Shtator 2011 e deri në muajin qershor 2014 e nga totali i tyre i kërkuar në shumë prej 54,470.00 € për periudhën kohore prej muajit Tetor të vitit 2003 deri në muajin Qershor të vitit 2014 dhe se shuma prej 419.00 € e pagës mujore të paditësit, ka qenë e marr për bazë për llogaritje në procedurën e likudimit, dhe se këtë shumë edhe kjo gjykatë e mori si bazë për llogaritjen e tillë të pagave të pa paguara derisa qëndron pjerësisht pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit, është e pas afatshme për pjesën tjetër të kërkesëpadisë mbi shumë e pranuar të saj pasi që kërkesat periodike kanë rrjedh veç e veç të afateve, si dhe çdo kërkesë e veçantë mujore eventuale duhet të argumentohet me prova konkrete materiale, për të cilën pala paditëse ka arritur të dëshmoj një fakt të tillë.

Pra gjykata pas shqyrtimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe të vërtetimit të gjendjes faktike, konstatoj se e paditura, nuk e ka kontestuar lartësinë e kërkesës së paditësit por ka konstatuar se paditësi pjesërisht, ka të drejtë që të kërkoj kompensimin e pagave të pa paguara dhe me këtë edhe e konsideron si të drejtë pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë së paditësit për pagat e paguara dhe atë për 4 muajt e vitit 2011, për vitin 2012, për vitin 2013, dhe për 6 muajt muajt e vitit 2014 në shumën e lartë shënuara e në shumë e pranuar prej 14,246,00 € për periudhën kohore prej muajit shtator 2011 e deri në muajin qershor 2014 e nga totali i tyre i kërkuar në shumë prej 54,470.00 € e për periudhën kohore prej muajit Tetor të vitit 2003 deri në muajin Qershor 2014 kurse pjesërisht e refuzon si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit për pagat e pa paguara mbi shumë e pranuar sepse kërkesëpadia e paditësit për këtë periudhë kohore, është e parashkuar pra, se është bërë pas kalimit të afatit të paraparë prej 3 (tre) vjetëve për paraqitjen e kërkesave nga marrëdhënia e punës sepse paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë se kërkesën për pagat e pa paguara e ka bërë para dt.19.04.2014 dhe atë para ndonjë gjykate apo autoriteti tjetër kompetent e që të kishte të drejtë të kërkonte pagat e pa paguara edhe për periudhën për muajt Janar – Tetor të vitit 2003 e deri në muajin Tetor të vitit 2011. Andaj nga gjendja e shkresave të lëndës, nuk del se është kontestuese baza juridike e kërkesës të cilën e paditura, e ka konsideruar si të parashkuar, e të cekur në Vendimin e AL-së, PRZ009 - 0161 të

dt.31.03.2015 dhe së këto pretendime të të paditurës, AKP-së, dhe qëndrimin e saj juridik të shprehur në këtë Vendim të AL-së, gjykata tani nuk mund të marrë si të drejtë kur e ka bërë refuzimin e kërkesës së parashtruesit, këtu paditësit, pasi që AL-ja, pjesërisht i ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën materiale nga neni 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L-034 për AKP-në lidhur me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (GZ nr.53 viti 1976), meqë nuk kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës sipas vendimit të AL-së, andaj të njëjtin vendim gjykata, pjesërisht e ndryshon, për një pjesë të kërkesë padisë së paditësit kurse pjesërisht e vërteton si të drejtë dhe të bazuar në ligj mbi pjesën e pranuar të kërkesëpadisë së paditësit dhe se ky qëndrim i kësaj gjykate bazohet në dispozitat nga neni 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L - 034 për AKP-në, që flet për Prioritetet e kërkesave dhe interesave, aty parashihet se : *''Në procedurat e likuidimit të gjitha Kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: .... kërkesat e pa siguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë...''* dhe nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 dhe se këto kërkesa dhe interesa të kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 nga neni 40 i Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në.

Për më tepër për kërkesat periodike, siç është në rastin konkret, bëhet fjalë në nenin 372 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978, që bënë fjalë për kërkesa periodike, aty thuhet se : *''Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) si kur është fjala për kërkesat periodike aksesore, sikundër është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesën periodike të atilla ... parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë''*. Në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesat për pagat e pa paguara e të cilat kanë natyrë periodike dhe këto kërkesa parashkruhen në afatin prej tre vjetëve nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. Po ashtu dispozitë të ngjashme ka edhe në nenin 353 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Nr.04/L-077 të dt.10 maj 2012, që flet për kërkesat periodike e në të cilin, thuhet se : *''Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) ....''*

Për ndërprerjen e afatit të parashkrimit për një detyrim në të holla e në rastin konkret në emër të kompensimit të pagave të pa paguara, në nenin 388 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr.29/78 me Plotësime dhe Ndryshimet e tij, Nr.39/85, Nr.45/89, dhe Nr.31/93) e që flet për ngritjen e padisë, aty parashihet se : *''Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës''*. Në rastin konkret, paditësi, kërkesën për kompensimin e pagave mujore në shumën prej 54,470.00 € për periudhën kohore prej muajit Tetor të vitit 2003 deri në muajin Qershor të vitit 2014 prej Ndërmarrjes Shoqërore (N.Sh), "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë (në likuidim), pranë AL-së në procedurën e likuidimit, është bërë me dt.11 Shtator 20014, dhe se me këtë veprim pala paditëse, e ka ndërprerë afatin e parashkrimit për një pjesë të pagave mujore kurse për pjesën tjetër të tyre, paditësit, është parashkruar e drejta për të kërkuar kompensimin e tyre pasi që paditësit, nuk ka ofruar prova se kërkesën e tij e ka bërë para dt.11 Shtator 2014 para ndonjë gjykate apo autoritetit tjetër kompetent.

Po ashtu edhe në nenin 369 të Ligjit të ri mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Nr.04/L-077 të dt.10 maj 2012, që flet për paraqitja e padisë, aty është përcaktuar se: *''Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës''*. Pra, me paraqitjen e kërkesës kreditore nga paditësi, me

dt.11.09.2014 pranë AL-së, si autoritet kompetent për shqyrtimin e saj, paditësi e ka ndërprerë afatin e parashkrimit të detyrimit në të holla - kompensimin e pagave të pa paguara nga



marrëdhënia e punës për pjesën e detyrimit në të holla – për pagat e pa paguara, pra për 4 muajt e vitit vitet 2011, për vitet 2012 dhe 2013. Me nga 12 paga mujore, si dhe për 6 muajt e vitit 2014 dhe se për këto vite kalendarike, nuk ka kaluar afati 3 (tre) vjeçar për parashkrimin e kërkesës së paditësit dhe me këtë veprim të bërë nga paditësi, është ndërprerë afati i parashkrimit të detyrimit në të holla në emër të pagave të paguara e në shumën e lartë cekur si dhe për periudhën e lartë cekur kohore derisa për pjesën tjetër të detyrimit në të holla – pagat e pa paguara prej muajit tetor 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, dhe deri në muajin Gusht të vitit 2011, kërkesa e paditësit, është e parashkruar sepse pala paditëse, nuk ka prova se para dt.11.09.2014, t'i jetë drejtuar gjykatës apo organit tjetër kompetent për realizimin e tyre, dhe se për këtë arsye edhe kërkesëpadinë e paditësit, e pranoj pjesërisht si të bazuar për një pjesë të kërkesëpadisë derisa pjesërisht e refuzoj si të pa bazuar për pjesën tjetër të saj .

Gjykata po ashtu duke vepruar në bazë të dispozitave nga neni 37 par.3 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, paditësit, ia ka pranuar përpos kërkesën kryesore në shumën prej 14,246.00 €, edhe pjesën e saj në emër të kamatës ligjore prej 10 %, si kërkesë aksesore për detyrimin kryesor në të holla prej 1,424,60 € sepse në këtë nen, citohet se *“Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”* derisa e ka refuzuar pjesën e kërkesës së paditësit e me të cilin e ka kërkuar edhe pjesën e kërkesëpadië së paditësit si të pabazuar për pagimin e kamatës ligjore vjetore në vlerë prej 3,5 % për çdo vit sepse kjo lartësi e kamatës nuk gjen zbatim në këtë natyrë të lëndëve e kjo parashihet edhe në bazë të nenit 37 par.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, e në të cilin, thuhet se : *“Dispozitat e këtij neni kanë efekt superior mbi dispozitat e mundshme kontradiktore të kontratave, zgjidhjeve, marrëveshjeve, aktgjykimeve apo rregullimeve tjera të lidhura nga Ndërmarrja apo në emër të saj”*.

### ***Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës***

Gjykata vlerëson se pjesërisht qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së se kërkesa e paditëses, i është parashkruar në kuptim të nenit 36.2.2. të Shtojcës së Ligjit të, Nr.04/L – 034 për AKP-në si dhe nenit 608 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar ( publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut lidhur me nenin 372 të LMD-së, Nr.29 të vitit 1978, pra për një pjesë të kërkesëpadiës së tij derisa pjesërisht nuk qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së të se kërkesa e paditëses, i është parashkruar për pjesën tjetër të kërkesës së tij e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore sepse paditësi ka qenë punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore (N.Sh), “Auto Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim) e në mungesë të provave në mbështetje të pretendimit rreth çështje së pagesës së akontacionit si dhe se sa a ka pasur të drejtë paditësi, që të jetë nënshkruar i listës gjegjëse për pagat e nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se paditësi, kishte ofruar shërbime punë për Ndërmarrjen Shoqërore (N.Sh), “Auto Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim), i kishte mbetur borxh pagat e pa paguara për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e pranuar pjesërisht derisa pjesërisht kërkesa e tij, i është parashkruar për pjesën tjetër të kërkesëpadiës. Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpadija e paditësit për një pjesë të kërkesëpadiës për kompensimin e pagave të pa paguara dhe atë se sipas një përllogaritjeje, pra për vitin 2011, paditësit, i takojnë 4 (katër) paga mujore neto në shumën prej 1,676.00 €, për vitin 2012, 12 paga mujore, në shumën prej 5,028.00 €, për vitin 2013, 12 paga mujore, shumën prej 5,028.00 € dhe për vitin 2014, 6 paga mujore, në shumën prej 2,514.00 € e në shumën e përgjithshme prej 14,246.00 € e nga totali i tyre i kërkuar në shumën prej

54,470.00 € për periudhën kohore prej muajit Tetor të vitit 2003 deri në muajin Qershor të vitit 2014 dhe se shuma prej 419.00 € e pagës mujore të paditësit, ka qenë e marr për bazë në

procedurën e likuidimit, dhe se këtë shumë edhe kjo gjykatë e mori si bazë për llogaritjen e tillë të pagave të pa paguara nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), “Auto Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim).

Pra gjykata gjeti se kërkesëpapia e paditësit, është pjesërisht bazuar dhe se Vendimi i AL-së, PRN16 - 0116 të dt.31.03.2015 pra, duhet të ndryshohet pjesërisht si dhe të detyrohet e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, që paditësit, R C nga Prishtina, t’ia paguaj pagat e pa paguara në shumën dhe periudhën e lartë shënuar për pagat e të pa paguara si dhe shumën prej 1.424,60 € në emër të kamatës ligjore prej 10 %, si kërkesë aksesore nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), “Auto Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim) derisa për pjesa e kërkesëpapisë së paditësit mbi pjesën e pranuar të saj, është pjesërisht e pabazuar për shkak të parashkrimit të pjesshëm të kërkesëspër kompensimin e pagave të papaguara e duke filluar nga muaji shtator i vitit 2003 e deri në muajin Gusht të vitit 2011 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH), “Auto Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe mbi shumën e pranuar si dhe kamatën ligjore vjetore në vlerë prej 3,5 % për çdo vit dhe si e tillë pjesa e kërkesëpapisë së paditësit, duhet të refuzohet pjesërisht si e pabazuar dhe Vendimi, PRN126-0161 i dt.31.03.2015 i të paditurës, Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), duhet të vërtetohet pjesërisht, si i drejtë dhe i bazuar në ligj..

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK)lidhur me nenin 153, 159, 160, 190, 197 dhe nenit 199 të Ligjit, Nr.03/L 066 për Procedurën Kontestimore (LPK).

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenit 62 par.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), gjykata vendosi që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore sepse pala paditëse, edhe pse e ka fituar pjesërisht procesin gjyqësor si dhe është e përfaqësuar nga avokati, i njëjti nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

## **DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2023:249983, 29.01.2024**

**Gjykatësi,  
Agron Hoxhaj**

### **KËSHILLË JURIDIKE :**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).